



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 54/09**

**Prishtinë, më 22.06.2009, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa**

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Riza Smaka dhe Hajdin Abazi.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani, Besa Gaxherri, Shkumbin Demaliaj, dhe Müfera Şinik.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Ardian Zalli Drejtor i TKPK-së, Vërshim Hatipi zv.Drejtor i TKPK-së, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, ICO, KDI.**

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorëve të Pavarur të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës nr. 03/2333/DO – 1459/1 dt. 10.06.2009 dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2008 Të ftuar: Përfaqësuesit e TKPK-së;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008 I ftuar : Lavdim Krasniqi, Drejtor i IGJK –së;**
- 4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Auditimin e Brendshëm nr. 03/L-128;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Armët nr. L 143/1 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike L -142 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;**
- 7. Të ndryshme.**

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

## 2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorëve të Pavarur të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës nr. 03/2333/DO – 1459/1 dt. 10.06.2009 dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2008

**Kryesuesi**, theksoi se për herë të parë po shqyrtojmë një raport të tillë të audituara. Për të dhënë informacione më tepër rreth tij, ia dha fjalën përfaqësuesit të TKPK-së.

**Ardian Zalli**, theksoi se arsyeja e vonësën së dërgimit të raportit në Kuvend, ka ndodhur për shkak të vonësës së dorëzimit të tij nga kompania audituese. Në anën tjetër kjo vonësë ka mundësuar që bordi i zgjedhur të shqyrtojë atë, dhe të njëjtin e ka nënshkruar.

**Vërshim Hatipi**, theksoi se raporti përmbush kushtet ligjore për auditim të pasqyrave financiare. Duke u bazuar në këto pasqyra, Trusti gjatë vitit 2008, për shkak të krizës në tregjet financiare ka shënuar humbje 92.5 milion € Investimet në depozita bankare në Kosovë kanë qenë të vetmet investime pozitive vitin e kaluar. Është më rëndësi të veçantë të ceket se kemi 231.000 kontribus në Trust, prej të cilëve 5924 janë pensionuar. Një ndër problemet që ka përcjellur Trustin është edhe çështja se disa kontribute paguhen dhe nuk shkojnë në llogari personale, sepse janë pa adresë. Problemet janë shfaqur për shkak të mungesës së të dhënave nga ATK-ja, e cila i verifikon katër deri gjashtë muaj me vonësë. Për këtë problem i kemi shkruajtur direkt punëdhënësve që të dërgojnë të dhënat e sakta në Trust. Si rezultat vitin e kaluar 26 mili €e kontributeve janë pa adresë. Shpenzimet e trustit në vitin 2008 kanë qenë 2.2 milion €, për dallim prej vitit kaluar që kanë qenë 2.1 mili € Arseja e kësaj rritjes për shkak të rritjes së ngarkesës nga menxhuesit e mjeteve në investimin e tyre. Ndërsa nëse i zbrisim shpenzimet që ngarkojnë menxhuesit e mjeteve, shpenzimet operationale të trustit janë reduktuar për 100.000 euro, për çka edhe kemi kërkuar zbritjen e tarifës menaxhuese.

**Riza Smaka**, theksoi do të duhej të jepeshin edhe përqindjet dhe jo vetëm shifrat numerike. Kërkoj sqarim për taksën menaxhuese të mjeteve. Pyeti sa është kompenzimi për anëtarin e bordit, ndërsa i vlerësoi si të paarsyeshme shpenzimet e bëra për kontraktor dhe konsulentë, kur dihet se anëtarët e bordit në bazë të pagave që kanë mund të konsiderohen ekspertë. Më pas kërkoj sqarim edhe për përshkrimin edukimi publik dhe termin hudhjet. Z. Smaka sugjeroi që mjetet e trustit do të ishte më mirë të investoheshin në shoqëri aksionare të pakufizuar apo të përzier, për shkak se investimi në shoqëri aksionare më përgjegjësi të kufizuar bart risk më të madhë.

**Myrvete Pantina**, duke komentuar shpenzimet operative, kërkoj një sqarim për rritjen e kostos së stafit. Theksoi se do të ishte mirë të bëhej klasifikim ekonomik (paga, meditje). Numri i puntorve në trust është 24 dhe në bazë të llogaritjeve del se paga mesatare 1.500 euro, prandaj për të sqaruar këto, do të ishte që raporti të përmban edhe klasifikimi i pagave dhe të dihet diferenca në mes nivelit të pagave. Zhvlerësimi dhe amortizimi kanë shënuar rënje të dukshme, çka tregon trend pozitiv, gjithashtu diskutabile paraqesin shpenzimet për kontraktor. Duke u ndërlidhur me mjetet e depozituara në bankat komerciale në Kosovë (Raiffeisen dhe Procredit Bank), dhe duke parë së Raiffeisen banak ofron interes më të lartë, pyeti nëse trustit edhe me tutje do të mbaj mjetet në të dy bankat, apo do të bartë të gjitha në Raiffeisen për shkak të ofrimit të kamatës më të lartë. Në raport ndër të tjera shifet se nga taksa menaxhuese janë grumbulluar mbi 2.5 milion euro, përderisa shpenzimet totale operative janë 2.204 milion euro dhe me këtu ka tepërcë të mjeteve, pyeti a planifikoni që në vitin e ardhshëm të kërkonin të ulët taksa menaxhuese?

**Haki Shatri**, theksoi se na raport shifet se në vitin 2007 janë investuar mjetet të larta në letra financiare me një fitim të ultë. Po ashtu edhe në vitin 2008 janë investuar mjetet në aksione ku fitimi ka qenë edhe më i ultë. Lidhur me këtë, pyeti se kush e ka marrë vendimin për investimin e mjeteve në blerjen e aksioneve në këtë kompani, nga të cilat fitimi ka qenë minimal?

**Hajdin Abazi**, theksoi se kur është fjala për tërheqjen e kursimeve me rastin e punësimit, ku thuhet se deri ne 2000 euro kanë të drejtë të tërhiqen te gjitha parat e kursyera për një herë, ndërsa mbi shumën 2000 euro duhet te tërhiqen ne pagesa mujore ne vlerë të 100 eurove ne muaj. Kjo mënyrë e shpërndarjes së kontributeve po e dëmton person i cili ka me shumë se 2000 euro te grumbulluare ne Trust. Pasi që në deklaratat dërguar kontribuesve reflektohen humbjet e trustit, u interesua të dinte se a reflektohet edhe fitimi eventual në pasqyrat e këtyre kontribuesve.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se është hera e parë që kemi një raport të tillë, dhe kjo është e mirë për Kuvendin sepse nuk ka ditur se çka po ndodh me mjetet e trustit. Në bazë të këtij raporti po i shohim disa të dhëna të prezantuara se çka po ndodh me menaxhimin e mjeteve të trustit. U interesua të dinte për numrin e stafit që të mund të arsyetoheshin shpenzimet e bëra. Pyeti deri kur është paguar bordi vitin e kaluar, si dhe kërkoi sqarim për mjetet e trustit që janë deponuar vetëm në dy banka në Kosovë. Pasi që raporti do të kalojë në seancë për shqyrtim, theksoi se do të ishte mirë të ftohej edhe kryetari i bordit të TKPK-së.

**Armend Zemaj**, vlerësoi raportin të mangët për shkak të mos specifikimit të të dhënave. Kërkoi sqarim për blerjet apo investimet te cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2008. Duke komentuar depozitim e mjeteve të trustit në bankat vendore me kamatë vjetore 5.9%, theksoi se përkundër deponimit të shumave më të mëdha, norma nuk ndryshon, prandaj pyeti nëse ka mundësi që mjetet të investohen në ndonjë bankë që ofron kamatë më lartë. Gjithashtu shfaqti shpresën se do të zgjidhet problemi me ATK rreth identifikimit të kontribuesve dhe qe njerëzit që paguajnë kontribute, shumta e paguar të iu shkoj në llogari të tyre personale.

**Ardian Zalli**, në përgjigjen e pyjeve për deponimin mjeteve në bankat komerciale, theksoi se arsyeja e mbajtjes së këtyre mjeteve në Procredit Bank qëndron në faktin se për hirë të sigurisë ne kemi kërkuar nga kjo bankë që të blejë një bono thesar nga qeveritë e shteteve te zhvilluara, dhe në rast falimentimi kemi mbulesën në këtë bono e thesarit. Ndërsa arsyeja deponimit të mjetet vetëm në dy banka, është e kushtëzuar me faktin se është kërkuar nga ofertuesit (bankat) një auditim i pavarur për pasqyrat financiare, për të parë rejtingun e tyre, dhe pas kësaj kemi mësuar se vetëm këto dy banka i plotësojnë kushtet. Ndërsa arsyeja e mos investimit të mjeteve më tepër 5% është për shkak se ligji ndalon që të investohet më tepër në një entitet. Bashkpuojm edhe me nje bankë te jashtëm “Fortis Bank” qe është bankë me rejting te lartë “AAA”, ka disa miliarda pasuri. Mjetet e mbetura suficit mbesin në llogari të trustit dhe nëse shpenzimet operative janë më të vogla ne kërkojmë zbritjen e taksës menaxhuese. Të gjitha mjetet e kontribuesve ruhen në llogari te Bankës Qendrore të Kosovës dhe bordi është kompetent të vendos se qfarë të bëhet me ato mjete. Nëse vendos të i investoj, urdhëron BQK-në të veprojë ashtu. Ndërsa arsyeja e mosdhënies së të gjitha mjeteve kontribuesit i cili i plotëson kushtet, ka të bëj me faktin se praktika ka treguar se marrësi ato i ka investuar gabimisht dhe më pas bëhen barrë e qeverisë. Kurse sa i përket pyetjes për investimin e mjeteve në letra me vlerë me fitim të ultë, mjetet e trustit janë investuar me vendimin e bordit të kaluar deri në shtator 2008, ndërsa pas asaj kohe nuk ka pasur investime. Trusti grumbullon pesë deri shtatë milion euro ne muaj, ku këto mjete grumbullohen në BQK dhe vitin e kaluar politika e bordit ka qene të investohen 60% ne ekuitete dhe 35% ne bonot e thesarit, 5% në depozita bankare.

**Riza Smaka**, insistoi të dinte për pagat e anëtarëve të bordit të TKPK-së për shkak se kemi të bëjmë me paranë publike dhe kjo nuk është çështje sekrete.

**Kryesuesi**, theksoi se pagat e bordit përcaktohen në të njëjtin nivel sikurse edhe bordeve të agjencioneve të tjera, ndërsa nivelin e pagave të stafit menaxherial e përcakton ligji. Përndryshe theksoi se raporti i audituar i plotëson kriteret financiare edhe pse dallon nga raportet tjera për shkak të specifikave të veta, dhe vërejtjet eventuale që u bënë këtu do të rekomandohet për miratim në Kuvend dhe do të kërkohet të ftohet kryetari i bordit të Trustit që të raportojë para Kuvendit në seancë plenare. Kryetari kërkoi nga përfaqësuesit e TKPK-së që bazë të eksperiencës që keni, të japin sugjerimet e tyre për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, nëse mendojnë se kjo i kontribuon investimit dhe menaxhimit më të mirë të mjeteve.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Raporti i Audituar i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2008 i plotëson standartet ligjore të kontabilitetit për raportim.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare të miratojë Raporti i Audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2008.
- III. I rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, që në seancën plenare, me rastin e shqyrtimit të Raportit të Audituar të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2008, të ftohet Kryesuesi i Bordit të TKPK-së, që të raportojë në Kuvend.
- IV. Me qëllim të krijimit më të mirë të bazës ligjore për investimin dhe menaxhimin e mjeteve të TKPK-së, Komisioni, i propozon Kuvendi që të kërkojë nga Qeveria formimin e grupit punues, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-084 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës.

### **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008**

**Kryesuesi**, njoftoi se për shkak të dërgimit të materialit jo të kompletuar (ku mungon pjesa financiare e raportit), propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **PËRFUNDIM**

- I. Raporti financiar i Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008, shtyhet për mbledhjen e radhës së komisionit.

### **4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Auditimin e Brendshëm nr. 03/L-128**

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se grupi punues i komisionit, në bashkëpunim me MEF-in dhe NJHQAB kanë arritur të bëjnë disa ndryshime të projektligjit, të cilat janë propozuar në formë të propozim-amendamenteve. Gjatë punës një ndër çështjet më problematike ka qenë çështja e auditimit të ndërmarrjeve publike. Nga konsultat që kemi pasur duke përfshirë edhe MEF-in, ka

mbetur që ndërmarrjet publike të mos auditohen në bazë të këtij ligji, por të mbetet që ato të auditohen në bazë të ligjit për ndërmarrjet publike. Ndër ndryshimet tjera, ka qenë krijimi i komiteteve të auditimit brenda organizatës kryesore buxhetore, dhe këto komitete do të jetë funksionale në të gjitha njësitë dhe nën-njësitë e asaj organizate. Ndërsa për çështjen e pagave të auditorëve të brendshëm është menduar që Komisioni të rekomandojë që kjo të rregullohet me Ligjin për Pagat e shërbyesve civil. Po ashtu është diskutuar edhe çështja e përzgjedhje së drejtorit të AB, dhe ka mbetur që një përfaqësuese i NJHQAB të marrë pjesë në komisionin e rekrutimit. Më pas shpjegoi propozim - amendamentet një nga një.

Në vazhdim anëtarët shqyrtuan propozim - amendamentet e grupit punues, bënë modifikimin e disa prej tyre, të cilat do të pasqyrohen në raportin e komisionit me rastin e procedimit të mëtejshëm të këtij projektligji.

Pas shqyrtimit të propozim amendamenteve të grupi punues dhe dhënies së propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **REKOMANDIM**

- I. Miratohen propozim – amendamenteve të grupit punues për Projektligjin për Auditimin e Brendshëm
- II. Raporti me amendamente procedohet në procedurë të mëtutjeshme për miratim në Kuvend.

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për Armët nr. L 143/1 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Anëtarët e komisionit diskutuan propozim amendamentet e komisionit funksional lidhur me kufirin minimal dhe maksimal të vendosjes së gjobave për armëmbajtjen pa leje.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve konkrete, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Armët nr. L 143/1 dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike L -142 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike L -142 dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **7. Të ndryshme**

**Kryesuesi**, kërkoi që të krijohen dy grupe punues, për shqyrtimin dhe amendamentimin e P/L për TVSH-së dhe P/L për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Pas dhënies së disa propozimeve, Komisioni krijoi dy grupe punues:

Grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit të TVSH-së, në përbërje të cilit janë caktuar këta anëtarë:

**Armend Zemaj (kryesues), Safete Hadërgjonaj, Haki Shatri dhe Myrvete Pantina.**

Grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për tatimin në të Ardhurat e Korporatave, në përbërje të cilit janë caktuar këta anëtarë:

**Riza Smaka (kryesues), Kosara Nikolic dhe Shkumbin Demaliaj.**

Mbledhja përfundoi në ora 13:30

**Përgatitur nga**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

\_\_\_\_\_  
**Gani KOCI**